



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 3913 prot.

Tiranë, më 05.09.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.923, datë 21.12.2005.

**SHOQËRISË “ELBASAN CEMENT FACTORY” SH.P.K
Rruga “Abdyl Frashëri”, Pallati 11/1, kati 7, Tiranë.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT
NË MINIERA**

Rr. “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “Elbasan Cement Factory” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.923, datë 21.12.2005, për mineral argjilë, në objektin “Bradashesh 2”, Elbasan.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së, me shkresën nr.424, datë 14.01.2019, jeni njoftuar se duhet të kryeni rehabilitimin e sipërfaqes së prekur nga shfrytëzimi për lejen minerare nr.923, datë 21.12.2005, për mineral argjilë, në objektin “Bradashesh 2”, Elbasan. Kjo shkresë i është dërguar për dijeni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, protokolluar me nr.529/10, datë 15.01.2019.

Gjithashtu nga AKBN-ja me shkresën nr.3512, datë 25.04.2017, protokolluar në Ministrinë Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.2616, datë 02.05.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.923, datë 21.12.2005, për mineral argjilë, në objektin “Bradashesh 2”, Elbasan, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit për sipërfaqen e prekur, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Leja juaj është dhënë në bazë të Ligjit nr.7796, datë 17.02.1994, “Minerar të Shqipërisë”, të ndryshuar, që është shfuqizuar me Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Afati fillestar i vlefshmërisë së lejes suaj ka përfunduar më datë 21.12.2015 dhe ju nuk keni kërkuar zgjatje të afatit, siç përcaktohet në pikën nr.6, të nenit 24, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Në këtë nen përcaktohet: *“Afati i aplikimit është prekluziv dhe, me kalimin e këtij afati zotëruesi i lejes minerare humbet të drejtën e aplikimit për shtyrje të afatit të lejes së shfrytëzimit”*.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.923, datë 21.12.2005, për mineral argjilë, në objektin “Bradashesh 2”, Elbasan, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes së shfrytëzimit nr.923, datë 21.12.2005, për mineral argjilë në objektin “Bradashesh 2”, Elbasan.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

